



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me neni 17 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje neneve 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miraton këtë:

**Projekte-V E N D I M**  
Për formimin e komisionit

**Neni 1**

Formohet komisioni për ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste në objektin afarist-banesor që do të ndërtohet nga **Bashkim Sali HOXHAJ** dhe **z. Sami Dervish ELSHANI** në parcelën kadastrale **P-72116046-01165-5**, të cilëve ju është dhënë në shfrytëzim me Vendimin e Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-016-32543 të datës 29.07.2020 dhe sipas kontratës 01-Nr-016-37358 të datës 19.08.2020 për ndërtimin e objektit afarist-banesore, në këtë përbërje;

- 1.1. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.2. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.3. -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 1.4. -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës
- 1.5. -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës

**Neni 2**

**2.1** Detyrat dhe përgjegjësit e komisioni janë që të bëjnë ndarjen dhe definimin e banesave dhe lokaleve afariste që i takojnë Komunës në objektin që do të ndërtohet nga investitorët e cekur më lart në parcelën e cekur në nenin 1 të këtij vendim.

**2.2** Komisioni po ashtu të bënë kompensimin dhe barazimin e banesës Nr. 1 me sipërfaqe prej 48.74m<sup>2</sup> dhe banesës Nr. 2 me sipërfaqe prej 36.56m<sup>2</sup> me pronar Bashkim Sali Hoxha nga Suhareka, të cilat janë të ndërtuara në parcelën kadastrale P-72116046-01165-6 sipas certifikatës së pronës **nr. 37358-2023** datës 20.01.2023, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtura “Pojata/Slloxa”, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, e në cilën parcelë ka mu ndërtuar objekti afarist banesore nga investitorët e lartcekur. Kompensimi të bëhet në të njëjtin objekt ku kanë me ndërtuar investitorët në pronë të Komunës së lartcekur.

**2.3** Pas arritjes së marrëveshjes përfundimtare të hartojnë marrëveshjen dhe t’i rekomandojnë Kryetarit të Komunës që marrëveshjen ta miraton në Kuvendin e Komunës së Suharekës dhe tek atëherë nënshkruhet nga Kryetari i Komunës me palët investuese.

### **Neni 3**

**Autorizohet komisioni i lartcekur** që pas ndarjes dhe definimit të banesave dhe lokaleve afariste që i takojnë Komunës, sipërfaqja e lokaleve afariste që i takojnë Komunës të shndërrohen në banesa banimi për Komunën.

### **Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## **KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË**

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Me datë\_\_\_\_\_

**Kryesuesi Kuvendit**  
\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**